

Statistikat afatshkurtra

Shërbimet - Tremujori I 2019


Tiranë, më 19 Qershor 2019: Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 5,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




Transport, Magazinim dhe Posta

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Posta, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 7,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 7,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)




Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 6,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 22,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 21,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)




Bar, Restorante

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 20,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 18,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Bar-Restorante (%)




Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 18,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 12,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)




Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 19,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 8,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 13,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekturore dhe Inxhinierike (%)




Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 4,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 6,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2018.

Fig. 7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)



Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2015=100)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.I 2019 (2015=100)	I.19 / I.18 (%)	Tr. I 2019 (2015=100)	I.19 / IV.18 (%)
G	45+46 +47	Tregti	97,0	5,3	111,1	3,4
H	49-53	Transport dhe Magazininim	108,5	7,5	123,6	-0,6
I	55.1	Hotele	117,6	6,8	155,8	8,9
I	56	Bar-Restorante	157,4	2,3	162,3	0,9
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	86,2	2,3	93,2	2,2
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	183,9	-19,2	203,1	-17,7
N	79	Agjenci udhëtimi	126,4	4,9	151,8	0,1

Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2015=100)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja		Tr.I 2019 (2015=100)	I.19 / I.18 (%)	Tr.I 2019 (2015=100)	I.19/ I.18 (%)
G	45+46+47	Tregti	111,1	1,9	110,1	3,3
H	49-53	Transport dhe Magazininim	112,5	1,8	119,5	7,2
I	55.1	Hotele	125,5	22,4	132,2	21,9
I	56	Bar-Restorante	176,8	20,6	200,2	18,8
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	114,3	18,2	106,4	12,3
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	123,1	8,3	145,5	13,5
N	79	Agjenci udhëtimi	128,1	0,9	157,5	6,9

Shënime metodologjike

Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2017, realizuar nga INSTAT.
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante).

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në Shërbime

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjeve neto - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shitjeve neto - Objektiv i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime.

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

Indeksi i Numrit të punësuarve - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2,1. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecificimin X-13 në serinë kohore Tremujori 1 2006 - Tremujori I 2019. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.